



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
URDHRI I PSIKOLOGUT



Në vijim gjeni rekomandimet e Urdhrit të Psikologut për rezultatet e konsultave online, të cilat i janë përcjellë me anë të një shkresë zyrtare informative dhe shterruese së bashku me të dhënat e përfutuara edhe:

Sh.T.Z. Edi RAMA  
Kryeministër i Shqipërisë

Z.Gramoz RUÇI  
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Znj.Ogerta MANASTIRLIU  
Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Znj.Besa SHAHINI  
Ministre e Arsimit Sportit dhe Rinisë

Znj.Etilda GJONAJ  
Ministre e Drejtësisë

Znj.Olta XHAÇKA  
Ministre e Mbrojtjes

Z.Sandër LLESHAJ  
Ministër i Brendshëm

... Urdhri i Psikologut nga problematikat e hasura në popullsi dhe frekuenca e tyre, për t'i ardhur në ndihmë popullsisë dhe parandaluar regresin psikologjik të personave të prekur, si dhe për të minimizuar kostot financiare të qeverisë për trajtimin e tyre, nëse do të avanconin në një fazë kritike, rekomandon:

1. Nisjen e fushatave sensibilizuese për popullatën për marrjen e shërbimeve psikologjike.
2. Nisjen e fushatave sensibilizuese për bashkërendimin e punës dhe të punuarit në ekipe multidisiplinare mjek i familjes – psikolog - psikiatër.
3. Nevojën imediate për depistim të popullatës mbi shëndetin mendor.
4. Nevojën imediate për shtim të numrit të psikologëve të punësuar pranë qendrave të shëndetit mendor në rang vendi, të cilat ofrojnë ndihmën falas për popullsinë.
5. Nevojën imediate për shtim të numrit të psikologëve të punësuar pranë qendrave spitalore në rang vendi.
6. Nevojën imediate për shtim të numrit të psikologëve pranë bashkive në rang vendi, që mbulojnë me shërbim çerdhet dhe kopshtet.
7. Nevojën imediate për shtim të numrit të psikologëve të punësuar në shkollat e sistemit 9-vjeçar dhe të arsimit të mesëm (një problematikë e hershme kjo).